

INCIDENCA E HIPODERMOZËS NË GJEDHË NË KUSHTE AMBULATORE NË DISA RRETHE TË KOSOVËS

DRITON SYLEJMANI¹, AVNI ROBAJ¹, ARTAN ISMAJLI²

¹ Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

² Ambulanta Veterinare "Veterinarius", Ferizaj, Kosovë

ABSTRACT

The aim of this study was to determine the incidence of cattle hypodermosis in Ferizaj and Malishevo regions in Kosovo during april 2008- april 2009 period. It is parasitic disease caused by larvae of *Hypoderma* spp. (*Hypoderma bovis* and *Hypoderma lineatum*). A total of 879 cattle were examined clinically by the visual and hand palpation method in the dorsal and lumbal region for presence of Hypodermosis. The incidence of cattle hypodermosis was 18%. Incidence of hypodermosis was higher in cattle older than 3 years of age (21.5%) than in cattle of 0-3 years (12%). These results indicated that hypodermosis is a serious economic threat to livestock and farmers in these regions. Therefore, for the control of hypodermosis, proper prophylactic measures are imperative to reduce the intensity of damage caused by that parasite.

Keywords: Incidence, hypodermosis, hypoderma spp., cattle

PËRMBLEDHJA

Qëllimi i këtij studimi qëndron në përcaktimin e incidencës së hipodermozës në gjedhët e rrethit të Ferizajt dhe Malishevës në Kosovë gjatë periudhës prill 2008 – prill 2009. Është sëmundje parazitare që shkaktohet nga larvat e *Hypoderma* spp. (*Hypoderma bovis* dhe *Hypoderma lineatum*). Janë vizituar klinikisht 879 krerë gjedhë përmes metodës vizuale dhe palpimit në rajonin lumbo-dorzal për prani të Hipodermozës. Incidenca e hipodermozës ishte 18%. Incidenca më e lartë e hipodermozës ishte te gjedhët me moshë mbi 3 vjet (21.5%) se sa te ata me moshë 0-3 vjet (12%). Këto rezultate tregojnë se hipodermoza përbën një dëm serioz ekonomik për bagëtinë dhe fermerët në këto regjione. Prandaj, për kontrollin e hipodermozës aplikimi i masave parandaluese është i domosdoshëm në uljen e intensitetit të dëmeve të shkaktuara nga ky parazit.

Fjalët çelës : Incidenca ,hipodermoza ,hipoderma spp., gjedhë .

HYRJE

Hipodermoza është një sëmundje parazitare, miazë specifike e kafshëve shtëpiake dhe të egra ripërtypëse e përhapur gati në gjithë botën e që shkaktohet nga larvat e *Hypoderma* spp. apo larvat e diptereve të familjes Oestridae (Zumpt, 1965). Kjo sëmundje prekë gjedhët e të gjitha moshave dhe racave e sidomos ata që mbahen në regjim kullor në muajt e nxehtë të vitit. Hipodermoza nga ana e fermerëve tanë njihet shumë pak si sëmundje e fare pak për dëmet shëndetësore dhe ekonomike që mund të shkakton ajo. Aktualisht, në vendin tonë nuk kemi ndonjë të dhënë apo raport mbi shkallën e pranisë së kësaj sëmundje në gjedhë. Insektet e rritura kanë nevojë për një klimë me pak erë dhe temperaturë më të lartë se 18°C për një fluturim dhe vendosje efikase të vezëve të tyre në trupin e kafshëve (Gregoire me bashkepun.1952). Infestimi i gjedhit nga këto larva reflektohet klinikisht me shfaqjen e nyjeve larvare në lëkurën e shpinës dhe në zona tjera trupore të kafshës. Larvat (L1) e insekteve hipoderma shpojnë lëkurën e kafshëve dhe migrojnë deri në kanal in rakidian e ezofag (L2 dhe L3) dhe shpojnë lëkurën, dalin jashtë ku transformohen në pupa e prej tyre në miza seksualisht të pjekura (Fig. 1 dhe 2). Sipas studimeve të bëra në këtë fushë në Shqipëri ekzistojnë të dy llojet e hipodermave, *H. bovis* e cila ka një shtrirje në gjithë territorin e vendit dhe *H. lineatum* e cila gjendet në pjesën jugore (Hipodermatoza e gjedhit dhe e dhive; Tagari V. dhe Bujari Y, Institutit i Lartë Bujqësor, Tiranë, 1989, fq. 57-59). Gjatë vitit 2003 është realizuar një hulumtim në Shqipëri mbi praninë dhe seroprevalencën e hipodermozës në 625 krerë gjedhë të vizituar dhe mostruar gjatë dy sezoneve shkurt-mars dhe nëntor-dhjetor, ku 133 (38.6%) nga 344 dhe 116 (41.3%) nga 281 kafshë kanë rezultuar seropozitive

kurse sipas rajoneve ka rezultuar se kafshët nga pjesa jugore kanë paraqitur përqindjen më të lartë të rezultateve seropozitive të hipodermozës (72.8% dhe 97.8%), të përcjella nga pjesa veriore (35.8% dhe 23.8%) dhe pjesa qendrore (17.8% dhe 3.4%) (Domenica Otranto, Pellumb Zalla me bashkp.,2003). Në shekullin e kaluar, prevalenca e hipodermozës së gjedhit nga *Hipoderma* spp., në kuadër të ekzaminimit klinik parazitologjik të 2.2 milion gjedhëve në Republikën e Çekisë dhe Sllovakisë ishte 80%, në Greqi 49.2%, në Itali 85%, në Spanjë 52.3%, në Mbretërinë e Bashkuar 40% dhe në Rumani 32-43% (O'Brien,1997). Në vitin 2005, prevalenca e hipodermozës në një krahinë të Turqisë (Kars) ishte 31.9% në një popullacion prej 1276 krerë gjedhë (Kara et al.,2005). Hipodermoza e gjedhit ka ndikuar në prodhimtarinë e kafshëve jo vetëm përmes dëmtimeve mekanike në organe dhe lëkurë (Fig.4 dhe 5) por edhe duke e dobësuar sistemin imunitar të tyre (Zumpt 1965; Boulard,2002). Ky studim është i pari i këtij lloji në shkallë vendi.

Totali i gjedhëve të prekur nga Hypodermoza	Rajoni i shpinës – rajoni lumbo-dorzal	%	Rajoni skapulo-humeral	%
161	160	99.4	1	0.6

Tabela 1. Frekuenca e Hipodermozës në gjedhë sipas rajoneve trupore të kafshës



Fig. 1. Një larvë të *Hipoderma* spp. në rajonin e shpinës së gjedhit



Fig. 2. Moment nga dalja e larvës së stadi të III-të të *Hipoderma* spp., nga nënlëkura e gjedhit

MATERIALI DHE METODAT

Gjatë këtij studimi ishin ekzaminuar klinikisht 879 krerë gjedhë në fshatra të ndryshme të rrethëve të Ferizajt dhe Malishevës në Kosovë për prani të kafshëve të infestuara ose jo të infestuara nga hipodermoza. Vizitat janë realizuar në aspektin klinik në fushë dhe stallë në dy etapa: gjatë periudhës prill 2008 (318 krerë gjedhë femra dhe 119 meshkuj) dhe prill 2009 (320 krerë gjedhë femra dhe 122 meshkuj), duke përdorur metodën vizuale dhe atë të palpacionit duke identifikuar gungat larvare të stadi të tretë (L3). Gjedhët e marr në studim ishin të racave (Frizis, Simental dhe raca mikse) dhe moshave (0-3 vjet dhe mbi 3 vjet) të ndryshme. Këta muaj të studimit janë zgjedhur për faktin se manifestimi klinik i hipodermozës në vendin tonë është shumë i shprehur. Vizitat kanë qenë të rastësishme dhe në kushte ambulatorë duke evidentuar të dhënat për çdo krerë gjedhë të prekur ose jo nga kjo sëmundje sipas moshës, seksit dhe rajonit trupor të kafshës. Në përgjithësi gjedhët e vizituar kishin regjim kullosor me përjashtim të gjedhëve të rinj (viqave) dhe demave të cilët kishin regjim kryesisht stallor.

Mosha e gjedhëve të vizituar	Numri i gjedhëve të vizituar	Nr. i gjedhëve të prekur nga Hypodermoza	% e gjedhëve të prekur nga Hypodermoza
0-3 vjet	303	37	12 %
mbi 3 vjet	576	124	21.5 %
Totali	879	161	18 %

Tabela 2. Incidenca e Hipodermozës në gjedhë sipas grup moshës, prill 2008- prill 2009

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Në bazë të rezultateve të pasqyruara në tabelën 2., shihet se incidenca e hipodermozës në gjedhët me moshë mbi 3 vjet ishte më e lartë (21.5%) se ata të moshës 0-3 vjet (12%). Kafshët e kësaj moshe kishin një regjim kryesisht kullosor kurse ata të moshës 0-3 vjet kishin regjim më shumë stallor. Incidenca e hipodermozës në totalin e kafshëve të vizituar ishte 18%. Mirpo këto rezultate në rastin tonë vijnë nga fakti sepse fermerët tonë përgjithsisht nuk i lëshojnë gjedhët e moshës së re (viqat e demat) në kullotë. Incidenca e hipodermozës në kafshët femra ishte më e lartë (17% dhe 27.18% gjatë dy periudhave të kontrollit) se të meshkujt (7.5% dhe 9.0%) tab.3. Poashtu, sipas të dhënave nga ekzaminimi klinik i realizuar gjatë vitit 2009 hipodermoza rezultoi të jetë më e përhapur (22.17%) në krahasim me vitin 2008

(14.4%). Kafshët femra (lopët dhe mëshqerrat) me regjim kullor të të ushqyerit janë shumë më të predispozuar për tu infestuar se sa kafshët meshkuj (demat) sepse këto të fundit në pjesën më të madhe mbahen të lidhur dhe në regjim stallor (Scholl dhe Wientraub,1988). Shumë faktorë të tjerë mund të ndikojnë në prevalencën e hipodermozës si regjimi i të ushqyerit sidomos ai kullor (Otranto et al., 2001). Frekuenca e hipodermozës rezultoi shumë e lartë në rajonin e shpinës së gjedhit (99.4%) tab.1., dhe vetëm një rast nga gjithsejt 161 krerë gjedhë të infestuar (0.6%) e kemi hasur në rajonin skapulo-humeral të trupit të kafshës Fig.3. Në një studim të realizuar në Thraki të Turqisë prevalenca e hipodermozës në gjedhin e therrur me moshë mbi 1 vit duke përdorur metodën e kontrollit klinik dhe ate vizuele, nga 365 krerë gjedhë të vizituar (234 meshkuj dhe 131 femra)

gjatë periudhës Janar dhe Maj të vitit 1997, ishte 3.56% respektivisht 10.23% (Aynur GÛLANBER me bashkp.1997).



Fig. 3. Larva të stadi të III-të të Hipoderma spp., të nxjerra nga nënlëkura e gjedhit

Seksi i kafshës	Kafshët e kontrolluara në prill 2008	Të infestuara	Kafshët e kontrolluara në prill 2009	Të infestuara
Femra	318	54 (17%)	320	87 (27.18%)
Meshkuj	119	9 (7.5%)	122	11 (9.0%)
Totali	437	63 (14.4%)	442	98 (22.17%)

Tabela 3. Incidenca e Hipodermozës në gjedhë bazuar në seksin e kafshës

KONKLUZIONE

Në bazë të rezultateve të fituara gjatë këtij studimi mund të nxjerrim këto përfundime:

- Incidenca e hipodermozës në këto rajone të Kosovës ishte më e lartë te gjedhët me moshë mbi 3 vjet,
- Kafshët e seksit femër ishin më të prekura nga hipodermoza në krahasim me ata meshkuj,
- Hipodermoza e gjedhit ishte më shumë e shfaqur klinikisht në rajonin e shpinës
- Regjimi kullor ka ndikuar në incidencën më të lartë të kësaj sëmundje në kafshët më të vjetra dhe te ato të seksit femër,
- Shkalla e përhapjes së hipodermozës në gjedhë ishte më e lartë gjatë vitit 2009 se sa në vitin 2008 në numër gati të njëjtë të gjedhëve të ekzaminuar klinikisht,
- Duhet të merren masa parandaluese dhe terapeutike sistematike duke i trajtuar kafshët me larvicide të ndryshëm si: Cyprin-100EC (Cypermethrin me sperkatje) apo Ivermectin injektabel, me qëllim të uljes së nivelit të kësaj sëmundje dhe pengimin e përhapjes së saj në një shkallë më të lartë dhe më të gjerë. (Zoonozat parazitare, S. Zanaj,1998).



Fig. 4. Vrima (gjurma) në lëkurën e gjedhit pas daljes jashtë të larvës së Hipoderma spp.,



Fig. 5. Lëkura e gjedhit pas therjes, e infestuar dhe invaduar nga larvat e Hipoderma spp.

BIBLIOGRAFIA

1. Boulard, C., 2002. Durably controlling bovine hypodermosis. *Vet. Res.*, 33: 455-64.
2. Gregoire C., Koch H., Deberdt A., Latteur J.P.: L'hypodermose bovine en Belgique. *Ann. Med. Vet.*, 1952, 96, 52-172
3. Kara, M., M.O. Arslan and Y. Gicik, 2005. The prevalence of bovine Hypodermosis in Kars Province, Turkey. *Trop. Anim. Hlth. Prod.*, 37: 617-22
4. O'Brien, D. J., 1998. Warble Fly Prevalence in Europe 1997. COST 811
5. Otranto, D., P. Zalla, G. Testini, G. and S. Zanaj, 2005. Cattle grub infestation by *hypoderma* sp. *In: Albania* and risk for European countries. *Vet. Parasitol.*, 128: 157-62
6. Scholl, P.J. and J. Weintraub, 1998. Gonodotrophic development in *Hypoderma lineatum* and *H. bovis* with notes on reproductive capacity. *Ann. Entomol. Soc. America*, 81: 318-24
7. Tagari V., Bujari Y. 1989. Hipodermatoza e gjedhit dhe e dhive. Instituti i Lartë Bujqësor. Tiranë
8. Zanaj, S. (1998). Zoonozat parazitare: Universiteti Bujqësor i Tiranës. 268-270
9. Zumpt, F., 1965. Myiasis in Man and Animals in the Orld World, p: 267. Butterworths, London